



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 30/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi në ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës – dega Gjilan, në seancën e mbajtur më datë 09.11.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Shtabi Zgjedhor i PDK-së në Gjilan, më datë 23.10.2009 ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – dega në Gjilan më datë 21.10.2009 ka grisur dhe vendosur posterat e tyre në hapësirat e PDK-së.

FAKTET

Më 23.10.2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Kryetari i Shtabit Zgjedhor të Degës së PDK-së në Gjilan, më datë 21.10.2009, duke pretenduar se përfaqësuesit e subjektit politik të AAK-së, kanë bërë shkelje ligjore, në *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*

Parashtruesi i kësaj ankese ka bashkangjitur edhe një foto të skanuar, me kualitet të dobët duke mos specifikuar një përshkrim të hollësishëm duke përfshirë vendin e ngjarjes dhe kohën e saktë.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe pika (c) parasheh si vijon:

- (b) një përshkrim të hollësishëm, duke pëfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar;
- (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat janë në posedim të ankuesit.

KZAP-i konsideron që PDK-ja nuk ka plotësuar nenin 3.6 të Rregullave dhe Procedurave dhe për më tepër, nuk ka sjellur fakte të qëndrueshme të cilat janë të lidhura me rastin në fjalë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 30/2009 më datën 9.11.2009.

Kryesuesi i Panelit
~~Osman Tmava~~

